





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	28.01.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Znj. Sanije Maloku Menaxhere e Zyrës së Prokurimit
CC:	z. Lavdim Krasniqi Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Sigurimi Fizik i Objektivit"

Të nderuar

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin " Sigurimi Fizik i Objektivit" me numër prokurimit : IGJK322-12-001-221 ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues(në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Sigurimi Fizik i Objektivit" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 - L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Zyrtari Autorizues i një Autoriteti Kontraktues e autorizon iniciimin e një aktiviteti të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të prokurimit një udhëzim me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmerin e Fondeve të nënshkruara, të cilat kopje të këtyre dokumenteve i mban zyra e prokurimit për prokurimin përkatës, mirëpo nga dokumentacioni i kontrolluar nuk kemi hasur se kjo kërkesë është përgatite për inicim të procedurës së prokurimit por procedura prokurimit është iniciuar në bazë të Deklaratës së nevojave dhe Disponueshmeris së mjeteve, nga kjo rrjedh se AK nuk ka respektuar nenin 22 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Zyra e prokurimit në Institutin Gjyqësor të Kosovës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime" të procedurës së hapur me nr. Prokurimi IGJK322 -12 -001 -221 dhe titulli i tenderit " Sigurimi Fizik i Objektit" në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 7.2 i Dosjes së tenderit të Kërkesat mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 1,3 dhe 6 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë : Një kopje të planit dhe procedurat e menaxhimit të përgjithshëm të punës në sigurim të rojeve gjatë ofrimit të shërbimit në IGJK, Një kopje e programit të trajnimeve , Ofruesi duhet të ofroj kualifikimin dhe përvojën e punës për rojet të cilat do të angazhohen në IGJK.

Zyra e prokurimit në IGJK, këto kërkesa i ka shpalosur edhe një herë duke i zbërthyer te Kriteret e Dhënies (tenderi ekonomikisht më i favorshëm), ku si nën kriteret për dhënie të kontratës në pikat 2,3 dhe 4 ka paraparë: Trajnimi fillestar dhe i rregullt për rojet që do të angazhohen në IGJK, Kualifikimi dhe përvoja e punës për rojet që do te angazhohen në IGJK, Plani dhe procedurat e menaxhimit të përgjithshëm të punës në sigurim.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- **Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042.**

Zyra e prokurimit në IGJK, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit, te PJESA C, Formulari i dorëzimit të tenderit, pika 4 ka plotësuar validitetin e ofertës për një periudhë prej 60 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderit gjë që nuk është në përputhje me **nenin 20** Rregullores për Prokurim Publik ngase këtë pikë duhet plotësuar Operatoret Ekonomik.

Me respekt!